



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 39, datë 11.11.2019

PËR

“NJË NDRYSHIM TË VSA NR. 27, DATË 09.10.2019, MBI MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE, CIKLI I DYTË I STUDIMEVE, MASTER PROFESIONAL, NË FAKULTETIN E MUZIKËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1 dhe 2 të nenit 3, pikën 1 shkronjat a, dh dhe f të nenit 38 si dhe të pikave 1, 4 dhe 6 të nenit 39 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; shkresën me nr. 321/1 Prot., datë 28.10.2019, e Dekanit të Fakultetit të Muzikës mbi riorganizimin e planeve mësimore për ciklin e dytë të studimeve, Master profesional për vitin akademik 2019-2020, në zbatim të Urdhrit nr. 512, datë 24.10.2019 të MASR, Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve, si dhe në prezantimin e të gjitha programeve të studimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master Profesional dhe Mësuesi, për vitin akademik 2019-2020, nga Drejtuesit e Departamenteve dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve të planeve mësimore të Fakultetit të Muzikës, për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master Profesional dhe Mësuesi, për vitin akademik 2019-2020, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të dërguar nga Fakulteti i Muzikës.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)



Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI